

Vendim nr. 84 datë 24.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 24.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (K) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KLEONARD PIPA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-2293, datë 12.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Kleonard Pipa është caktuar përfaqësues ligjor i shtetasës E.B. me anë të prokurës së posaçme nr. 2708 rep., nr. 708 kol., datë 07.05.2011, nëpërmjet së cilës ka marrë përsipër ta përfaqësojë atë në cilësinë e palës paditëse, në gjykimin e çështjes gjyqësore kundër palës së paditur S.N.V. “Organizata Holandeze për Zhvillim/Shqipëri”, me seli në Tiranë, me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditëses dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, në përputhje me Kodin e Punës.”*. Tagrat e caktuar me prokurë përfshijnë veprimet e përfaqësuesit ligjor deri në ekzekutimin përfundimtar të vendimit, përfshirë këtu edhe zgjidhjen e çështjes jashtëgjyqësisht e me pajtim mes palëve, deri në tërheqjen e shumës që do të jepej në emër të saj.

2. Ndërmjet palëve është lidhur përpara noterit, në datën 10.06.2011, edhe kontrata e shërbimit nr. 3269 rep., datë 10.06.2011, nëpërmjet së cilës janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Sipas kontratës, kërkuesi në cilësinë e përfaqësuesit ligjor do të ushtronte të gjitha të drejtat dhe tagrat e dhëna me prokurë të posaçme nga ana e të përfaqësuarës, ndërsa shtetasja E.B. ka marrë përsipër detyrimin t’i paguajë atij një shpërblim për shërbimin e ofruar, në masën prej 10% të vlerës totale të caktuar me vendim gjykate të formës së prerë, sapo të ekzekutohej vendimi gjyqësor dhe shuma e caktuar monetare që rridhte nga ky proces gjyqësor të tërhiqej nga pala e paditur. Kjo klauzolë ishte e vlefshme edhe nëse çështja do të zgjidhej me pajtim mes palëve me ose pa ndonjë vendim përfundimtar gjykate që do ta zgjidhte atë në themel. Ky detyrim monetar përbënte titull ekzekutiv dhe ishte i detyrueshëm për klientin, pavarësisht të ndonjë akti tjetër noterial, ndonjë revokimi ose tërheqjeje të mëvonshme pa shkak të arsyeshëm nga ana e tij.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8365, datë 27.10.2011, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur S.N.V. “Organizata Holandeze për Zhvillim/Shqipëri” që ta dëmshpërblejë paditësen E.B. me një total prej 32 (tridhjetë e dy) pagash mujore, me një pagë mujore bruto në shumën 245,078 lekë/muaj. Sipas këtij vendimi, shuma totale e dëmshpërblimit të përfituar nga paditësja është 7,842,496 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur.

4. Në vijim, pasi e ka njoftuar paraprakisht në mënyrë verbale, shtetasja E.B. i ka dërguar kërkuesit aktin noterial “Revokim Prokure” nr. 136 rep., nr. 20/2 kol., datë 16.01.2012, duke e shkarkuar atë nga të gjitha përgjegjësitë si përfaqësues ligjor në këtë çështje. Ajo është përfaqësuar nga një tjetër përfaqësues ligjor gjatë gjyqimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 924, datë 18.04.2012, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit civil me nr. 8365, datë 27.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.”*.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 128, datë 17.01.2013, ka vendosur: *“Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr. 13428/3484 Regjistri Themeltar”*, pasi pala paditëse ka depozituar kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi dhe për pushimin e çështjes, sepse ndërmjet palëve ndërgjyqëse çështja në fjalë ishte zgjidhur me mirëkuptim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 22.01.2013.

7. Sipas marrëveshjes nr. 15792 rep., nr. 5414 kol., datë 21.12.2012 *“Për zgjidhjen me pajtim të çështjes gjyqësore”*, të lidhur mes palëve ndërgjyqëse dhe të regjistruar pranë noterit J. Zh., shtetasja E.B. ka përfituar në total 21 paga mujore dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës, të barasvlefshme me shumën totale prej 5,146,638 lekësh.

8. Në vijim, kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesëpadi me objekt detyrimin e palës së paditur E.B. për të përmbushur detyrimet kontraktore të parashikuara në kontratën e shërbimit nr. 3269 rep., datë 10.06.2011 *“Për përfaqësim ligjor në Gjykatë”*, në vlerën 514,664 lekë.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7286, datë 26.06.2013, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur E.B. që të përmbushë detyrimet kontraktore të parashikuara në kontratën e shërbimit “Për përfaqësim ligjor në gjykatë”, të lidhur mes palëve dhe të regjistruar pranë noteres me nr. 3269 rep., datë 10.06.2011, duke paguar në favor të ofruesit të shërbimit paditësit Kleonard Pipa, vlerën totale të shpërblimit për shërbimin e ofruar prej tij, në shumën prej 514,664 Lekë të reja të përcaktuar në këtë kontratë. - Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.11030 Akti, datë 19.04.2013 [...]”*. Ky vendim është kundërshtuar nga shtetasja E.B.

10. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2966, datë 11.07.2014, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 7286, datë 26.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si vijon: Rrëzimin e kërkesëpadisë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditësit”*, me arsyetimin se kontrata e shërbimit që është lidhur mes palëve ka pushuar së prodhuari efektet e saj juridike që nga momenti i revokimit të prokurës së posaçme nr. 2708 rep., nr. 708 kol., datë 07.05.2011, me aktin noterial *“Revokimin e Prokurës nr.136 rep., nr. 20/2 kol., datë 16.01.2012”*, fakt për të cilin kërkuesi është njoftuar. Që nga ky moment, kërkuesi nuk e ka përfaqësuar më të paditurën në

çështjen gjyqësore, për të cilën ishte lidhur kontrata për përfaqësim ligjor, pasi e shtetasja E.B. ka vendosur të zgjidhë kontratën e shërbimit me kërkuesin përpara përfundimit të çështjes. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2293, datë 12.10.2022, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse Kleonard Pipa, kundër vendimit nr.2966, datë 11.07.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë”*, me arsyetimin se në rekursin e paraqitur nuk ngrihet asnjë shkak i parashikuar nga ligji që e bën të cënueshëm vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë.

12. Kërkuesi në datën 10.03.2023 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2293, datë 12.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

II

Pretendimet e kërkuesit

13. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi gjyqësor i kundërshtuar i ka cenuar:

13.1. *Parimin e gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, në kundërshtim të plotë me ligjin, duke iu referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore, por pa i analizuar dhe vlerësuar ato.

13.2. *Parimin e ligjshmërisë*, pasi në mbështetje të dispozitave ligjore të kërkesëpadisë dhe të kontratës objekt gjykimi, vendimi nr. 2966, datë 11.07.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë është në shkelje flagrante dhe në zbatim të gabuar të ligjit. Për rrjedhojë, mbështetur në sa më sipër, sikurse edhe në mendimin e gjyqtarit në pakicë të Gjykatës së Lartë, i cili është i bazuar, tërësisht i argumentuar dhe duhet të merret parasysht nga Gjykata, edhe vendimi nr. 00-2022-2293, datë 12.10.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranim rekursi është dhënë në kundërshtim me ligjin. Mendimi i gjyqtarit në pakicë është mbështetur në vendimin nr. 58, datë 05.12.2014 të Gjykatës, përmes të cilit është njohur e drejta e shpërblimit sipas ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

15. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

16. Kolegji vlerëson se kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi objekt kundërshtimi në Gjykatë.

17. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuari ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

18. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar.

Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që nuk ka pranuar rekursin e tij kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë ai e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

20. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që kundërshtohet prej tij është dhënë në datën 12.10.2022, kurse ankimi kushtetues individual i kërkuetit është paraqitur në Gjykatë në datën 10.03.2022, pra tej afatit ligjor 4-mujor. Kërkuesi ka pretenduar se është larguar në drejtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e nuk ka qenë në Shqipëri për një kohë të gjatë dhe për këtë arsye ka marrë dijeni me vonesë për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 10.03.2023, e cila korrespondon me datën e tërheqjes së vendimeve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

22. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se është detyrë e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 13, datë 04.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vështrim të këtyre standardeve, Kolegji vlerëson se në kushtet kur ka qenë vetë kërkuesi që përmes rekursit ka iniciuar procesin, ai ka

pasur edhe detyrimin të interesohej për ecurinë e gjykimit të çështjes së tij dhe të merrte informacion për të edhe pse jetonte jashtë shtetit.

23. Nga ana tjetër, Kolegji çmon se fakti i pretenduar nga kërkuesi se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 10.03.2023, e cila korrespondon me datën e tërheqjes së vendimeve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra kur është interesuar për të marrë informacion pranë saj, nuk është i mjaftueshëm për të provuar në nivel kushtetues se kjo është data e marrjes dijeni për vendimin objekt kundërshtimi, për sa kohë është në të drejtën e palës së interesuar të kërkojë dhe të tërheqë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, në çdo moment në sekretarinë e gjykatës, kopje të vendimit gjyqësor.

24. Përveç sa më sipër, Kolegji vëren se në rekursin e paraqitur bashkëlidhur ankimit kushtetues nuk rezulton që kërkuesi të jetë kujdesur për të shënuar të dhënat elektronike të kontaktit me qëllim njoftimin nga sekretaria e Gjykatës së Lartë, çka do të mundësonte njoftimin e drejtpërdrejtë të tij edhe për vendimmarrjen e saj. Sipas nenit 485/b të Kodit të Procedurës Civile (KPC) “Njoftimi i vendimit të Gjykatës së Lartë” referon në nenin 316 të këtij kodi, ndërsa paragrafi 2 i këtij të fundit, në nenet 128 e vijues të saj, që përcaktojnë mënyrat e njoftimit të akteve, ndër të cilat, neni 141 i KPC-së parashikon edhe atë elektronik. Bazuar në këtë dispozitë, si dhe në kompetencat e parashikuara në nenin 37 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me urdhrin nr. 131, datë 02.07.2021 “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore të këtij institucioni për njoftimin në rrugë elektronike të palëve për të tre llojet e gjykimeve para saj, konkretisht gjykimet administrative, civile dhe penale (*shih pikën 5 të këtij urdhri*).

25. Po kështu, Kolegji konstaton se referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit, në datën 27.09.2022, ka shpallur listën e çështjeve që do të shqyrtoheshin në datën 12.10.2022 në dhomën e këshillimit nga Kolegji Civil, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji çmon se kërkuesi ka pasur akses për të marrë informacion të mjaftueshëm për çështjen e tij edhe nga jashtë Shqipërisë (në Shtetet e Bashkuara të Amerikës), ku pretendon se ka qëndruar në atë periudhë.

26. Në vështrim të sa më sipër, për sa kohë kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues. Në

këtë aspekt, duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual, nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kritereve të tjera të legjitimitit të kërkuarit.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.